

NJOFTIM
PËR SHPALLJEN E KONKURRIMIT PËR POZICIONET E DREJTORËVE
TË DREJTORIVE RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
TIRANË, DURRËS, FIER, LEZHË DHE KORÇË

Në mbështetje të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pikës 14, të kreut III, të vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar, urdhrit nr. 144, datë 01.08.2024, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare dhe drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar”, dhe urdhrit nr. 454, datë 13.9.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirimimin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, të ndryshuar, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall procedurat e konkurrimit për pozicionet:

- Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë
- Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës
- Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier
- Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë
- Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë

I. Kërkesat e përgjithshme që duhen të plotësohen nga kandidatët janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të zotëroj gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
5. Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
6. Të mos jetë larguar nga puna me masë disiplinore.

II. Kërkesat e posaçme që duhen të plotësohen nga kandidatët janë:

1. Të ketë mbaruar arsimin e lartë në shkencat shoqërore/ekonomike/natyrore/juridike.
2. Të ketë mbi 10 vjet përvojë pune, nga të cilat të paktën 5 vite në drejtim.
3. Të ketë njohuritë bazë në kompjuter.
4. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi, certifikata).

III. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>;
2. Letër motivimi;
3. Diploma/t e përfundimit të arsimit të lartë shoqëruar me listën e notave. (*Për diplomat e fituara jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet dokumenti i njohjes dhe njësimit nga institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë*);
4. Certifikatë për gjuhët e huaja, për njohuritë në kompjuter si dhe të kualifikime të ndryshme;
5. Librezë pune (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Fotokopje e kartës së identitetit;
7. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
9. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
10. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
11. Vërtetim nga gjykata që nuk ka proces penal.

Të gjitha dokumentat që janë fotokopje duhet të dorëzohen të njësuara me origjinalin.

Aplikimi i shoqëruar me dokumentet e sipërcituar do të dorëzohen nga kandidatët nëpërmjet shërbimit postar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në adresën: “Rruga e Durrësit”, Nr. 23, AL 1001, Tiranë.

IV. Përshkrimi përgjithshëm i punës për pozicionin e drejtorit të drejtorisë rajonale të arsimit parauniversitar:

- a. Kontrollon dhe garanton përmbushjen e misionit, objektivave dhe detyrave të drejtorisë rajonale të arsimit parauniversitar të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- b. Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e drejtorisë nëpërmjet akteve të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga punonjësit e drejtorisë.
- c. Mbikqyrë veprimtarinë e zyrave vendore të arsimit parauniversitar brenda juridiksionit territorial të drejtorisë rajonale të arsimit parauniversitar.
- d. Përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për arsimin për zbatimin e politikave, strategjive dhe programeve në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe përpara Sekretarit të Përgjithshëm për sigurimin e mbarëvajtjes së administrimit financiar, burimeve njerëzore, veprimtarisë arkivore, dokumentare dhe aktiveve të drejtorisë qëndrore në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe rregullatore në fuqi.
- e. Raporton te drejtori i përgjithshëm i AKAP-it për zbatimin e politikave, strategjive dhe programeve në fushën e arsimit parauniversitar, në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe rregullatore në fuqi.
- f. Raporton tek drejtori i përgjithshëm i AKAP-it mbi verifikimin e pajtueshmërisë me aktet ligjore dhe nënligjore të veprimtarisë së zyrave vendore të arsimit parauniversitar

dhe institucioneve të arsimit parauniversitar publike dhe private, brenda juridiksionit territorial të drejtorisë rajonale të arsimit parauniversitar

- g. Informon në mënyrë periodike drejtorin e përgjithshëm të AKAP-it, për problemet e ndryshme në lidhje me planet e punës apo arritjen e objektivave.
- h. Përfaqëson drejtorinë në marrëdhëniet me të tretët si dhe autorizon personat që mund të përfaqësojnë drejtorinë në mungesë të tij.
- i. Vlerëson kërkesat e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe përmbushjen e kritereve infrastrukturore për hapjen e institucioneve arsimore dhe ushtrimin e veprimtarisë në fushën e arsimit parauniversitar.

V. Verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit dhe shpallja e listës përfundimtare

Në përfundim të afatit të aplikimit, Komisioni *ad-hoc* pas shqyrtimit të dosjeve të aplikantëve do të shpallë në datën 18.10.2024, listën e kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme, në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit: (<https://arsimi.gov.al>).

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe/ose të posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore, për shkaqet e skualifikimit, nëpërmjet adresës së e-mail të deklaruar nga çdo kandidat.

Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtën e ankimimit brenda 3 (tre) ditëve pune nga marrja dijeni, për shkaqet e skualifikimit, nëpërmjet adresës së email-it të deklaruar prej tyre. Ankuesit do ti kthehet përgjigje brenda 3 (tre) ditëve pune duke filluar nga data e përfundimit të afatit të ankimimit.

Lista përfundimtare e kandidatëve të kualifikuar do të shpallet në datën 29.10.2024, në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit: (<https://arsimi.gov.al>). Në të njëjtën datë do të shpallet dhe njoftimi për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

VI. Fushat e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista

1. Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
4. Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
5. Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.
6. Vendimi nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar.

7. Vendimi nr. 621, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.
8. Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të ndryshuar.

VII. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen:

1. Vlerësimi i testimit me shkrim, deri në 60 pikë.
2. Vlerësimi për intervistën e strukturuar me gojë, deri në 25 pikë.
3. Vlerësimi për jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Për të kaluar në fazën e intervistës së strukturuar me gojë çdo kandidat duhet të marrë të paktën 30 (tridhjetë) pikë në testimin me shkrim.

VIII. Shpallja e fituesve dhe mënyra e komunikimit

Fituesit do të shpallen në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit: <https://arsimi.gov.al>.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet nëpërmjet adresës së tyre të email-it.

Shënim: Afati i dorëzimit të dokumentacionit do të jetë nga data 30.09.2024 deri në datën 15.10.2024.